



SUCCESS STORY

Dyqani i suvenireve tejkalon ndarjen etnike në Kosovë

Pajisjet e reja dhe më shumë produkte përmbushin kërkesat

Granti i marrë nga USAID i mundëson kompanisë në Mitrovicën veriore për të rritur biznesin e saj



Punonjësit e "Dhuratës" duke demonstruar aftësitë e performances së lartë të pajisjes së re

"Ne tashmë kemi punësuar 3 punonjës të rinj, por me këtë pajisje të re modern, pas dy muajve, ne do të punësojmë edhe dy persona më shumë," thotë Mirko Krivokapić, pronari i "Dhuratës"

Është thënë se marrëveshjet e biznesit i kalojnë kufijtë etnik. Dyqani i suvenireve "Gift" (dhurata) në pjesën veriore të qytetit të ndarë të Mitrovicës shërben si shembull.

Ky biznes i vogël familjar i themeluar në vitin 2004 ishte i tejmbushur me kërkesa nga klientët në mbarë vendi. Megjithatë, për të vazhduar me kërkesën e lartë të tregut krahas rritjes së gamës së produkteve të kompanisë duke përdorur pajisjet e vjetra, ishte e vështirë.

Një grant i USAID-it prej \$26.000 [30.000 euro] në korrik të 2013 ndihmoi kompanin në blerjen e makinës së shtypit, e cila mundësoi shtypin në materiale të ndryshme, përfshirë qelqin, plastikën dhe metalin. Kjo i mundësoi kompanisë të ofrojë një gamë të produkteve. Përveç kësaj, procesi është më i shpejtë dhe më i lirë, dhe suvenire janë të përballueshme për shumë konsumatorë.

Pronari i "Gift", Mirko Krivokapić, thotë se ai ka bërë një rrugë të gjatë që nga fillimi i prodhimit të suvenirëve, duke shtuar se puna e madhe, përkushtimi dhe dashuria për veprat artizanale të punuara me dorë në fund ka dhënë frytet e saj. Ai vlerëson se prodhimi së shpejti do të arrijë në 40 përqind më i lartë si rezultat i drejtpërdrejtë i grantit të marrë nga USAID.

"Ne tashmë kemi punësuar tre punonjës të rinj, por me këtë pajisje të re moderne, pas dy muajve, ne do të punësojmë edhe dy persona më shumë," shpjegon Mirko.

Kompania ka zgjeruar sasinë dhe gamën e produkteve për të furnizuar dyqanin në Mitrovicë, si dhe dyqanin me pakicë në selinë e KFOR-it në Prishtinë. Sot, klientët e "Gift" janë Kosovarë, shqiptarë dhe serbë.

Granti u mundësua përmes Programi e USAID-it për Nismën e Veprimit në Komunitete të USAID-it filloi në korrik të vitit 2010 dhe përfundon në korrik të vitit 2014. Programi mbështetë zhvillimin e komunitetit dhe rehabilitimin e infrastrukturës në 40 komunitete të Kosovës, ndërton organizata të forta të shoqërisë civile, dhe përmirëson mundësitë ekonomike dhe të punësimit.